

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina	
---	---	---

Datë/a:	21.11.2018
Për/ Za/ To:	Operatori Ekonomik: 2607
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 09.11.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: 2607, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Konkurs projektimi për hartimin e projektit për konservimin dhe adaptimin e Ndërtesës së Ish-Kadastrit, Prishtinë”, me Nr. të Prok: 616 18 73 421 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik 2607, të dt. 09.11.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Konkurs projektimi për hartimin e projektit për konservimin dhe adaptimin e Ndërtesës së Ish-Kadastrit, Prishtinë”, me Nr. të Prok: 616 18 73 421, kundër NJOFTIMI PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT- REZULTATET E VLERËSIMIT ARTISTIK – të AK –së, të datës 15.08.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit me titull “Konkurs projektimi për hartimin e projektit për konservimin dhe adaptimin e Ndërtesës së Ish-Kadastrit, Prishtinë”, me Nr. 616-18-4389-2-2-3, Nr. Brendshëm 616 18 73 421 dhe mbështet NJOFTIMIN PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT- REZULTATET E VLERËSIMIT ARTISTIK – të AK –së, të datës 07.11.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 18.06.2018 ka bërë njoftimin për konkursin e projektimit lidhur me tenderin me titull: *"Konkurs projektimi për hartimin e projektit "Konservimi dhe adaptimi i ndërtesës së ish-Kadastrit" Prishtinë"*, me Nr. 616-18-4389-2-2-3, Nr. Brendshëm 616 18 73 421.

Pranimi i ofertave të koduara nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 30.07.2018 Janë pranuar 3 oferta të koduara. Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të pranimit të ofertave dhe vlerësimit të tyre.

Me datë 07.11.2018, Autoriteti Kontraktues ka bërë NJOFTIMIN PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT- REZULTATET E VLERËSIMIT ARTISTIK - të AK -së, të datës 15.08.2018 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së, pas vlerësimit të projekteve ideore nga ana e Jurisë për ku secili anëtar ka dhënë vlerësimin e tij për çdo kriter të paraqitur në dosje.

Operatori Ekonomik: 2607, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Konkurs projektimi për hartimin e projektit për konservimin dhe adaptimin e Ndërtesës se Ish-Kadastrit, Prishtinë"**, me Nr. të Prok: 616 18 73 421 , kundër Njoftimit për Konkursin e Projektimit të aktivitetit të prokurimit te AK -së, të datës 07.11.2018 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë 23.08.2018 sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr.04/L-042, në të cilin pretendon:

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Fillimisht, duhet t'i referohemi nje vendimi te plotfuqishem nxjerr nga OSHP-ja ne lidhje me kete aktivitet te prokurimit. OSHP-ja ne vendimin e saj te dates 23.10.2018, aprovon ne tansi si te bazuar ankesen tone duke e kthyer lenden ne rishqyrtim. Gjithashtu, nepermjet vendimit te saj, OSHP-ja, konstaton qe Koncept Projekti me numer 1209, nuk ka respektuar detyre projektuese.

Ju rikujtojme edhe njehere qe mos respektimi I detyres projektuese perben shkelje te dispozitave te ligjit te prokurimit dhe te dokumentit "Rregulla dhe udhezuesi operativ per prokurimin publik. Eshte I cuditshem fakti, se nuk e keni perfille vendimin e OSHP-se. Perkunder ketij vendimi, keni vazhduar me poentimin maksimal ten je koncept projekti te papergjegjshem. Me poshte, i keni argumentet tona se pse koncept projekti 1209 eshte i papergjegjshem, dhe si i tille duhet eliminuar nga gara.

Na lejoni te ritheksojme qe cdo shkelje ligjore qe kemi supozuar e qe me vone OSHP na ka dhene te drejt nepermjet vendimit te nxjerr, ka te beje me Specifikimet teknike ose detyren projektuese te cilen nuk e ka respektuar Koncept Projekti 1209.

SHKELJA 1: Neni 7

Barazia në Trajtim/ Jo Diskriminimi

Faktet:

Pas shqyrtimit të konceptit që ka marr pikët maksimale **Projekti Nr. 1209** dhe krahasimin me kriteret vlerësuese të vendosura nga vet AK (Autoriteti Kontraktues), shihet qartë që Juria ka anuar në vlerësimin e saj, duke dhënë kështu pikët maksimale për një projekt konceptual i cili nuk ka ofruar zgjidhjen e kërkuar sipas detyrës projektuese të AK-së.

Koncept Projekti **Nr. 1209**, nuk ka përfillur disa kërkesa të obligueshme të detyrës projektuese siç janë kërkesat në pikën **5. Detyra projektuese, 5.1 Kërkesat specifike të dizajnit, 5.2**

Detyrat kryesore, Përmbajtja e projektit. (Shih Detyren projektuese)

SHKELJA 2: Neni 59

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Përkundër faktit që ligji kërkon që ekzaminim, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet duke u bazuar në kërkesat e vendosura në dokumentet tenderuese, juria nuk vepron kështu.

Përkundrazi, kjo juri vlerëson me pikët maksimale një projekt që OSHP-ja ka konstatuar që nuk ka respektuar detyrën projektuese.

Faktet:

Bazuar në kriteret vlerësuese të prezentuara nga vet AK-ja në detyrë projektuese:

Detyra projektuese

11. KRITERET VLERËSUESE

Vlerësimet e projekteve do të duhet të bëheshin në bazë të këtyre kriterëve:

Nënkriteri 1. (pesha 30 pikë)

Kriteri hapësinor (30), përfshinë:

Konceptin hapësinor të zgjidhjes

Raportin në mes të pjesëve dhe tërësisë hapësinore

Vlerat arkitektonike

Kualiteti i hapësirës

Racionaliteti inxhinierik dhe realizimi teknik.

Koncept projekti nr. 1209, i mungon Koncepti Hapësinor i zgjidhjes. Pra projekti nr. 1209, nuk merret fare me trajtimin e objekteve përreth dhe tërësive të tjera urbane, ashtu siç shkruan në këtë kriter vlerësimi.

Ndërsa propozimi jonë 2607 është vlerësuar me më pak pikë, përkundër faktit që ne kemi trajtuar zonën në sipërfaqe prej 22.5 ari, duke bërë një analizë më të gjerë zonës dhe ofruar zgjidhje konceptuale të rigjenerimit mjedisor në aspektin inovativ arkitekturor dhe ekonomik të hapësirës ku ndodhet aseti i trashëgimisë kulturore në mbrojtje. Trajtimi dhe promovimi i zonës së zgjeruar si një tërësi është bërë për faktin se në afërsi të ndërtesës së ish kadastrit me status të mbrojtjes ligjore si aset i trashëgimisë kulturore, ndodhet shkolla e parë shqipe, gjithashtu aset i trashëgimisë kulturore në mbrojtje. Në këtë kuadër, në vecanti dhe detyrimisht është respektuar ruajtja dhe respektimi i autenticitetit dhe integritetit të aseteve të trashëgimisë kulturore, kriter ligjor të përcaktuar në standardet profesionale dhe normativen ligjore për mbrojtjen dhe konservimin e aseteve të trashëgimisë kulturore (Ligji

Nr. 02/L-88 për trashëgimi kulturore, neni 6.4.

Monumentet arkitekturale nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme kanë një zonë të mbrojtjes, që është 50 metra nga perimetri i monumentit.)

Sa i përket racionalitetit inxhinierik dhe realizimit teknik: Ky elaborim është bërë në pikën IV,V dhe VI të konceptit tonë 2607.

Nën kriteri 2. (pesha 30 pike)

Kriteri programor (3), përfshinë:

Funksionaliteti dhe arsyeshmëria funksionale e zgjidhjes

Shfrytëzimi racional i hapësirës

Respektimi dhe përmbushja e detyrës projektuese dhe programit hapësinor

Koncepti projekti 1209, nuk ka analize hapësinore. Ne nuk po mund ta kuptojmë se si Autoriteti Kontraktues qofte nëpërmjet jurisë ose kujtdo qofte vazhdon dhe poenton maksimalisht një koncept projekt te mangët.

Më poshtë janë të paraqitura kërkesat e Autoritetit Kontraktues dhënë në Detyrën Projektuese (pjesë kryesore e konkursit të projektimit), mangësitë dhe mos respektimi i këtyre kërkesave nga projekti me Nr. 1209 dhe krahasimi me propozimin tonë 2607.

DETYRA PROJEKTUESE PËR KONSERVIMIN E NDËRTESESË ISH-KADASTRIT, PRISHTINË

Detyra projektuese, pika e 5.1 kërkesat specifike të dizajnit, nën pika 7. AK ka kërkuar që riorganizimi i brendshëm i katit të parë të jetë ambient sa më i hapur (open space)

Faktet:

Projekti Projekti Nr. 1209 në propozimin e tyre nuk ofrojnë zgjidhjen Open Space, e kërkuar nga Autoriteti kontraktues. Përpos kësaj, zgjidhje e tyre është edhe në kundërshtim me standardet dhe parametrat e projektimit (Standardi mjaft i përdorur në Evropë, rajon por edhe në vendin tonë: Erenest and Peter Neufert Architects, Data, third Edition)

Nga ana tjetër, propozimi jonë 2607 organizon katin e administratës me sistemin e hapur (Open Space) siç është kërkuar në detyrën projektuese dhe më mirë shfrytëzon sipërfaqen e dedikuar për 25 vendet, duke i ofruar çdo personi sipërfaqe minimale prej 5.0m²

5.2 KERKESAT KRYESORE QASJA

Kërkesa e komunës: Konservimi dhe adaptimi i ndërtesës duhet të merr parasysh edhe përmirësimin e kontekstit të afërm, duke larguar kioskët një katëshe duke ofruar hapësirë publike të gjelbëruar që mund të përdoret nga secili.

Faktet:

- OE (1209) në paragrafin 5/ pika 1.2 PARTERI DHE QASJA NE NDERTESES, e përshkruan parterin e ngushtë të hyrjes në objekt por jo edhe atë të afërm apo me të gjerë, pra nuk merret as me kioskët as me gjelbërimin dhe rregullimin e hapësirës përreth

që është kërkesë kryesore e detyrës projektuese;

- Përderisa propozimi jonë 2607 jep vështrim të shkurtër historik duke analizuar kompleksin e ndërtesave në lokacionin më të gjerë, me sipërfaqe rreth 22.5 ari

(shiko pjesën tekstuale Ndërtesa ish Kadastrë në Prishtinë, vështrim i shkurtër historik)

Përveç përshkrimit të pjesës tekstuale, propozimi jonë 2607 shoqërohet edhe me pjesën grafike, pra me pamje/perspektiva,

(shiko Perspektivat 1,2,3,4,5,6,7 dhe 8,);

5.2 KERKESAT KRYESORE QASJA

Per shkak të mungesës së hapësirave për parking, ky duhet ofruar diku tjetër.. Faktet:

- Projekti Nr. 1209, në paragrafin 5- PERSHKRIMI I PROJEKT PROPOZIMIT, në pikën 1.2 PARTERI DHE QASJA NE NEDERTESE, parasheh 11 parkingjet në bërthamë të dy ndërtesave historike, pa bërë analizë se si do të ndikojë parkingu në lokacion dhe në hapësirën e gjelbëruar publike si dhe nuk e përfillë largimin e parkingjeve, e që është kërkesë e detyrës projektuese;

- Projekti Nr. 1209 zhvendos stacionin e autobusit nga ndërtesa e ish Kadastrit, përballë shkollës së parë shqipe-më afër rrethit ekzistues.

Kjo zhvendosje, jo që nuk ofron zgjidhjen e kërkuar nga komuna, por ngarkon edhe më shumë komunikacionin duke shkaktuar kaos në rrethin ekzistues dhe degradon objektin fqinjë- Shkollën e parë Shqipe në Prishtinë.

(shiko 1209, pjesa grafike; Baza e Përdhësës);

- Për dallim nga projekti me piket maksimale 1209, propozimi jonë 2607 është bërë në raport me kërkesën 5.2 të detyrës projektuese, pra në mënyrë që të lirohet hapësira publike kemi propozuar që parkingu të largohet sipas kërkesës së Detyrës Projektuese të Autoritetit Kontraktues dhe të vendoset në oborr të Kuvendit Komunal.
- Stacioni i autobusëve zhvendoset më në jug, në këtë mënyrë duke e liruar qasjen në ndërtesë por edhe duke e shkarkuar komunikacionin në përgjithësi.

(shiko pjesën grafike; Situacioni i ngushtë);

PËRMBAJTJA E PROJEKTIT

Plani i konservimit dhe adaptimit të ndërtesës së ish-Kadastrit të Komunës së Prishtinës ndër të tjera duhet të përmbajë:

9. Detajet karakteristike arkitektonike
- 10 Perspektivat e ndërtesës me rrethinë
11. Fotografi – perspektiva të enterierit të propozuar me detaje
- 12 Paramasa dhe parallogaria për implementimin e punëve

Faktet:

- Projektit Nr. 1209, i mungojnë detajet që janë kërkuar në pikën 9 Detajet karakteristike arkitektonike të Përmbajtjes së projektit. Gjithashtu Projektit Nr. 1209 nuk ka prezentuar as rrethinat e ndërtesës që është kërkuar në pikën 10-Perspektiva e ndërtesës me rrethinë. Ju mungon kerkea nr. 11. Fotografi – perspektiva të enterierit të propozuar me detaje. Gjithashtu mungon edhe pika 12 e Përmbajtjes së Projektit; Paramasa dhe parallogaria për implementimin e punëve me specifikimin e materialeve dhe teknikën e punimeve.

- Përderisa në propozimin tonë 2607 prezentohen grafikisht detajet karakteristike të kërkuara nga AK (Shiko Detajet e paraqitura në pjesën grafike),

Gjithashtu në pjesën grafike kemi paraqitur tetë (8) vizatime perspektivat e ndërtesës, posaçërisht raporti i ndërtesës me rrethinë. (Shiko Perspektivat, 1,2,3,4,5,6,7 dhe 8),

Po ashtu në propozimin tonë, pjesën tekstuale, pika e V. Punimet konservuese dhe adaptuese të ndërtesës, ne kemi përshkruar punimet e restaurimit, adaptimit, riorganizimit dhe rregullimin e hapësirave në Përdhësë dhe Kat, si dhe rregullimin e parterit.

Gjithashtu kemi paraqitur edhe paramasën me koston e përafërt të realizimit të punimeve (Shiko pjesën tekstuale:Kostoja e Përafërt e realizimit të punimeve).

Nën kriteri 3

Kriteri ekonomik (20), përfshinë:

Aspekti ekonomik i zgjidhjes së projektuar

Racionaliteti i zgjidhjes

Mirëmbatja dhe shpenzimet e saj, bazuar në karakterin e objektit

Faktet:

- **Projektit Nr. 1209** nuk e arsyeton ekonomikisht e as funksionalisht ndryshimin e vertikaleve te tualeteve duke shkaktuar keshtu kosto shtese pa nevojë.

Shiko Vizatimin 04, Baza e katit

- **Propozimi jone 2607** ruan ne maksimum linjat e objektit duke minimizuar nderhyrjet ne te dhe vertikalet e tualeteve i vazhdon edhe ne Kat –pa bere modifikime tjera. Zgjidhja e ofruar e ndjek levizhmerine natyrale dhe respekton detyren projektuese duke ofruara zyra te medha qe ofrojne komoditet ne pune por duke nderhyre sa me shume kujdes ne disa mure te holla. (shiko Baza e Perdheses – Nderhyrja dhe Baza e Katit – Nderhyrja). Eshte menduar gjithashtu nje pike informimi si aneks i objektit qe mund te shperbje edhe si pike shitjeje te artizanateve me simbolike te qytetit te Prishtines, gje qe do te ndihmonte ne buxhetin per mirembajtjen e objektit ne teresi.

(shiko Situacioni i ngushte)

Nën kriteri 4

Kriteri i komunikacionit (10), përfshinë:

Lëvizjet pa pengesa e automjeteve

Parkimi

Garazhimi

Faktet:

- **Projektit Nr. 1209** ne paragrafin 5- PËRSHKRIMI I PROJEKT PROPOZIMIT, në piken 1.2 PARTERI DHE QASJA NE NEDERTESE parasheh 11 parkingjet ne bërthame të dy ndërtesave historike pa bërë analizë se si do ndikojë parkingu në lokacion dhe në hapësirën e gjëlberuar publike si dhe nuk e përfillë largimin e parkingjeve që është kërkesë edhe e detyrës projektuese;

Projektit Nr. 1209 zhvendos stacionin e autobusit nga ndërtesa e ish Kadastit përballë Shkollës së Parë shqipe-më afër rrethit ekzistues me cka e degradon objektin fqinj-Shkollën e Parë shqipe dhe ngarkon edhe më shume komunikacionin ne tërësi duke shkaktuar kaos ne rrethin ekzistues.

(shiko; Baza e Perdheses);

- **Projekti jonë 2607** për shkak të liritimit të hapësirës publike dhe qasjes më të mirë nga të gjitha anët në zonën e trajtuar propozon që parkingu të largohet sipas kërkesës dhe të

vendoset në oborr të Kuvendit Komunal;

Stacioni i autobusit zhvendoset më në jug në këtë mënyrë duke e liruar qasjen në ndërtesë por edhe duke liruar rrethin dhe duke shkarkuar komunikacionin në përgjithësi.

(shiko; Situacioni i ngusht);

Nen kriteri 5

Kriteri estetik dhe ekologjik / arkitektura e qëndrueshme (10), përfshinë:

Originaliteti i zgjidhjes

Inovacioni dhe vlera estetike

Zgjidhja konsekuente e tërësisë

Ruajtja dhe avansimi i hapësirës

Ruajtja e gjelbrimit ekzistues

Efiçienca energjetike.

SHKELJA 3: Neni 80

Përbërja dhe Vendimet e Jurisë

Ndonese nuk jemi te informuar, por gjithsesi ligjit te prokurimit por edhe normave te trashëgimisë kulturore, kuptojme qe te pakten njeri nga anetaret e jurisë duhet të jet ekspert në lemin e konservimit të ndërtesave të trashëgimisë kulturore.

Gjithashtu, nese i referohemi pikës 2 të ketij neni e që thotë **“Juria do të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kriterëve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit”**, dhe e krahasojmë me vlerësimin që e ka bërë kjo juri, shohim qartë që Juria nuk ka vepruar kështu. Përkundrazi, kjo juri ka poentuar me pikët maksimale Koncept Projektin 1209, i cili qartazi nuk ka respektuar vet kërkesat e AK-së, pra Detyrën Projektuese.

SHKELJA 4

Gjatë analizës dhe krahasimit të koncept projekteve, shume lehte mund te verehet qe koncept projekti 1209 eshte vleresuar pa asnje te merite me piket maksimale perkunder faktit qe ky koncept projekt shkele ne menyre drastike te pakten 4 Pika kryesore te detyres projektuese, te cilat I kemi renditur me poshte.

Detyra projektuese për konservimni dhe adaptimin e ndërtesës së ish-kadastrit, Prishtinë

5. Detyra projektuese

5.1 Kërkesat specifike të dizajnit

5.2 Detyrat kryesore

Përmbajtja e projektit

Shkelja 5

Rregullat dhe Udhezuesi operativ per prokurimin publik.

Pika 41. Ekzamini, Vleresimi dhe krahasimi i tendereve

41.3 Tenderet duhet te plotesojne substancialisht kushtet obligative teknike te specifikuar. Pra edhe ne kete udhezim theksohet qe aplikuesit duhet t'i plotesojne kushtet obligative teknike.

Nuk e dijmë se si keni mund ta vleresoni nje koncept projekt i cili nuk ka plotesuar kerkesat e juaja!

Konkluzionet

Ne kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues qe te ktheje serish lenden ne rivlerësim dhe te zbattoj ne tërësi vendimin e OSHP-se, tek i cili vërtetohen qarte qe Koncept Projekti 1209 nuk ka respektuar Detyrën projektuese te AK, dhe si I tille duhet te shpallet i papërgjegjshëm.

I. Baza ligjore për refuzim të kërkesës.

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin e projekteve duke bërë ekzaminimin e të gjitha dokumenteve të prezantuara në ofertat e pranuar me kodim.

Autoriteti Kontraktues hedhe poshtë pretendimin e OE dhe njëherit konfirmon se KK Prishtina ka vlerësuar projektet ne përputhje me LPP-ne.

Pretendimi 1: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet nenin 7 (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim) të Ligjit për Prokurimin Publik.

Ne përputhje me nenin 7 të LPP-se "**Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim**" par.2. dhe par.3 AK ka vepruar si në vijim:

2. *Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.*

4. *Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.*

Autoriteti Kontraktues që prej inicimit të aktivitetit, pranimi të ofertave të koduara, formimit të komisionit të vlerësimit me anëtar profesional e deri të hapja e projekteve

ideore për vlerësim dhe vlerësimi i projekteve (poentim) ka respektuar në tërësi nenin 7 të LPP-së.

b) Pretendimi 2: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet nenin 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve) të Ligjit për Prokurimin Publik..

Ne përputhje me nenin 59, par.1 të LPP-së, dhe nenin 80, par.1 të LPP-se, Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim për krijimin e komisionit vlerësues profesional për vlerësimin e projektit ideor të ofertave të koduara siç është paraqitur si në vijim në këtë nen:

"1.Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacionin dylësor lidhur me këtë çështje.

80.1 Juria duhet të përbëhet nga një numër tek, por në asnjë rast më pak se tre (3) persona fizikë. Këta persona do të caktohen nga autoriteti kontraktues dhe ata nuk mund të jenë të anëtarësuar në ose të ndërlidhur me ndonjërin nga pjesëmarrësit në konkurs. Nëse nga pjesëmarrësit kërkohet që të posedojnë ndonjë kualifikim të posaçëm profesional, së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të juriës duhet që po ashtu të posedojnë atë kualifikim ose barasvlerën e tij.

SHKELJA 1: Neni 7

Barazia në Trajtim/ Jo Diskriminimi

Faktet:

Pas shqyrtimit të konceptit që ka marr pikët maksimale **Projekti Nr. 1209** dhe krahasimi me kriteret vlerësuese të vendosura nga vet AK (Autoriteti Kontraktues), shihet qartë që Juria ka anuar në vlerësimin e saj, duke dhënë kështu pikët maksimale për një projekt konceptual i cili nuk ka ofruar zgjidhjen e kërkuar sipas detyrës projektuese të AK-së. Koncepti Projekti **Nr. 1209**, nuk ka përfillur disa kërkesa të obligueshme të detyrës projektuese siç janë kërkesat në pikën **5. Detyra projektuese, 5.1 Kërkesat specifike të dizajnit, 5.2 Detyrat kryesore, Përmbajtja e projektit.** (Shih Detyren projektuese)

AL-01

Pa koment.

OE vlerëson jurinë.

OPE vlerëson konkurruesin (nuk e di sa është shkelje qasja në dokumentacionin e OE konkurrent në ndërkohë që akoma nuk ka përfunduar procesi i vlerësimit ??!

SHKELJA 2: Neni 59

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Përkundër faktit që ligji kërkon që ekzaminim, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet duke u bazuar në kërkesat e vendosura në dokumentet tenderuese, juria nuk vepron kështu. Përkundrazi, kjo juri vlerëson me pikët maksimale një projekt që OSHP-ja ka konstatuar që nuk ka respektuar detyrën projektuese.

Faktet:

Bazuar në kriteret vlerësuese të prezentuara nga vet AK-ja në detyrë projektuese:

Detyra projektuese

11. KRITERET VLERËSUESE

Vlerësimet e projekteve do të duhet të bëheshin në bazë të këtyre kriterëve:

Nënkriteri 1. (pesha 30 pikë)

Kriteri hapësinor (30), përfshinë:

Konceptin hapësinor të zgjidhjes

Raportin në mes të pjesëve dhe tërësisë hapësinore

Vlerat arkitektonike

Kualiteti i hapësirës

Racionaliteti inxhinierik dhe realizimi teknik.

Koncepti projekti nr. 1209, i mungon Koncepti Hapësinor i zgjidhjes. Pra projekti nr. 1209, nuk merret fare me trajtimin e objekteve përreth dhe tërësive të tjera urbane, ashtu siç shkruan në këtë kriter vlerësimi.

Ndërsa propozimi jonë 2607 është vlerësuar me më pak pikë, përkundër faktit që ne kemi trajtuar zonën në sipërfaqe prej 22.5 ari, duke bërë një analizë më të gjerë zonës dhe ofruar zgjidhje konceptuale të rigjenerimit mjedisor në aspektin inovativ arkitekturor dhe ekonomik të hapësirës ku ndodhet aseti i trashëgimisë kulturore në mbrojtje. Trajtimi dhe promovimi i zonës së zgjeruar si një tërësi është bërë për faktin se në afërsi të ndërtesës së ish kadastrit me status të mbrojtjes ligjore si aset i trashëgimisë kulturore, ndodhet shkolla e parë shqipe, gjithashtu aset i trashëgimisë kulturore në mbrojtje. Në këtë kuadër, në vecanti dhe detyrimisht është respektuar ruajtja dhe respektimi i autenticitetit dhe integritetit të aseteve të trashëgimisë kulturore, kriter ligjor të përcaktuar në standardet profesionale dhe normativen ligjore për mbrojtjen dhe konservimin e aseteve të trashëgimisë kulturore (Ligji Nr. 02/L-88 për trashëgimi kulturore, neni 6.4. Monumentet arkitektuale nën mbrojtje të përkohshme ose të

përhershme kanë një zonë të mbrojtjes, që është 50 metra nga perimetri i monumentit.)

Sa i përket racionalitetit inxhinierik dhe realizimit teknik: Ky elaborim është bërë në pikën

IV,V dhe VI të konceptit tonë 2607.

Nuk mund të arsyetohet racionaliteti inxhinierik dhe realizimi teknik i përmbajtjeve të parapara me program jashtë pronës/zonës së përcaktuar nga KK PR. Për shembull parkingjet e punëtoreve janë paraparë jashtë pronës/zonës së përcaktuar me detyrë projektuese dhe atë në pronën e KK PR duke bërë shkelje të dyfishtë:

1. mos përmbushje të kërkesave esenciale nga detyra.

2. projektim të përmbajtjeve në pronë/zonë tjetër nga ajo e përcaktuar në detyrën projektuese.

Nën kriteri 2. (pesha 30 pike)

Kriteri programor (3), përfshinë:

Funksionaliteti dhe arsyeshmëria funksionale e zgjidhjes

Shfrytëzimi racional i hapësirës

Respektimi dhe përmbushja e detyrës projektuese dhe programit hapësinor

Koncepti projekti 1209, nuk ka analize hapësinore. Ne nuk po mund ta kuptojmë se si Autoriteti Kontraktues qofte nepermjet jurise ose kujdoqofte vazhdon dhe poenton maksimalisht nje koncept projekt te manget.

Më poshtë janë të paraqitura kërkesat e Autoritetit Kontraktues dhënë në Detyrën Projektuese (pjesë kryesore e konkursit të projektimit), mangësitë dhe mos respektimi i këtyre kërkesave nga projekti me Nr. 1209 dhe krahasimi me propozimin tonë 2607.

DETYRA PROJEKTUESE PËR KONSERVIMIN E NDËRTESES SË ISH-KADASTRIT,

PRISHTINË Detyra projektuese, pika e 5.1 kërkesat specifike të dizajnit, nënpika 7.

AK ka kërkuar

që riorganizimi i brendshëm i katit të parë të jetë ambient sa më i hapur (open space)

Faktet:

Projekti Projekti Nr. 1209 në propozimin e tyre nuk ofrojnë zgjidhjen Open Space, e kërkuar

nga Autoriteti kontraktues. Përpos kësaj, zgjidhje e tyre është edhe në kundërshtim me standardet dhe parametrat e projektimit (Standardi mjaft i përdorur në Evropë, rajon por edhe në vendin tonë: Erenest and Peter Neufert Architects, Data, third Edition)

Nga ana tjetër, propozimi jonë 2607 organizon katin e administratës me sistemin e hapur (Open Space) siç është kërkuar në detyrën projektuese dhe më mirë shfrytëzon sipërfaqen e dedikuar për 25 vendet, duke i ofruar çdo personi sipërfaqe minimale prej 5.0m²

OE 2607 në këtë pikë është vlerësuar mbi OE 1209 pikërisht për sistemin e hapur të aplikuar më tepër në planimetri dhe projekt ide të prezantuar.

5.2 KERKESAT KRYESORE QASJA

Kërkesa e komunës: Konservimi dhe adaptimi i ndërtesës duhet të merr parasysh edhe përmirësimin e kontekstit të afërm, duke larguar kiosqet një katëshe duke ofruar hapësirë publike të gjelbëruar që mund të përdoret nga secili.

Faktet:

- OE (1209) në paragrafin 5/ pika 1.2 PARTERI DHE QASJA NE NDERTESES, e përshkruan parterin e ngushtë të hyrjes në objekt por jo edhe atë të afërm apo me të gjerë, pra nuk merret as me kiosqet as me gjelbërimin dhe rregullimin e hapësirës përreth që është kërkesë kryesore e detyrës projektuese;

- Përderisa propozimi jonë 2607 jep vështrim të shkurtë historik duke analizuar kompleksin e ndërtesave në lokacionin më të gjerë, me sipërfaqe rreth 22.5 ari

(shiko pjesen tekstuale Ndërtesa ish Kadastri në Prishtinë, vështrim i shkurtër historik) Përveç përshkrimit të pjesës tekstuale, propozimi jonë 2607 shoqërohet edhe me pjesën grafike, pra me pamje/perspektiva,

(shiko Perspektivat 1,2,3,4,5,6,7 dhe 8,);

5.2 KERKESAT KRYESORE QASJA

Per shkak të mungesës së hapësirave për parking, ky duhet ofruar diku

tjetër..

*Nuk përcakton/ndryshon OE kërkesat programore (të detyrës projektuese).
Ose i parasheh ose jo parkingjet në kuadër të pronës/zonës së paracaktuar
nga autoriteti kontraktues.*

Faktet:

- Projekti Nr. 1209, në paragrafin 5- PERSHKRIMI I PROJEKT PROPOZIMIT, në pikën 1.2 PARTERI DHE QASJA NE NEDERTESE, parasheh 11 parkingjet në bërthamë të dy ndërtesave historike, pa bërë analizë se si do të ndikojë parkingu në lokacion dhe në hapësirën e gjelbëruar publike si dhe nuk e përfillë largimin e parkingjeve, e që është kërkesë e detyrës projektuese;
- Projekti Nr. 1209 zhvendos stacionin e autobusit nga ndërtesa e ish Kadastit, përballë shkollës së parë shqipe-më afër rrethit ekzistues.

Kjo zhvendosje, jo që nuk ofron zgjidhjen e kërkuar nga komuna, por ngarkon edhe më shumë komunikacionin duke shkaktuar kaos në rrethin ekzistues dhe degradon objektin fqinjë-Shkollën e parë Shqipe në Prishtinë.

(shiko 1209, pjesa grafike; Baza e Perdheses);

- Për dallim nga proejkti me piket maksimale 1209, propozimi jonë 2607 është bërë në raport me kërkesën 5.2 të detyrës projektuese, pra në mënyrë që të lirohet hapësira publike kemi propozuar që parkingu të largohet sipas kërkesës së Detyrës Projektuese të Autoritetit Kontraktues dhe të vendoset në oborr të Kunvendit Komunal.
- Stacioni i autobusëve zhvendoset më në jug, në këtë mënyrë duke e liruar qasjen në ndërtesë por edhe duke e shkarkuar komunikacionin në përgjithësi.

(shiko pjesën grafike; Situacioni i ngushtë);

Parkingjet e punëtoreve janë paraparë jashtë pronës/zonës së përcaktuar me detyrë projektuese dhe atë në pronën e KK PR duke bërë shkelje të dyfishtë:

1. mos përmbushje të kërkesave esenciale nga detyra projektuese.
2. projektim të përmbajtjeve në pronë/zonë tjetër nga ajo e përcaktuar në detyrën projektuese.

Nuk kam koment përpos, OE 2607 prap hyn në funksion të jurisë profesionale dhe bën vlerësime.

PËRMBAJTJA E PROJEKTIT

Plani i konservimit dhe adaptimit të ndërtesës së ish-Kadastrit të Komunës së Prishtinës ndër të tjera duhet të përmbajë:

9. Detajet karakteristike arkitektonike
- 10 Perspektivat e ndërtesës me rrethinë
11. Fotografi – perspektiva të enterierit të propozuar me detaje
- 12 Paramasa dhe parallogaria për implementimin e punëve

Faktet:

- Projektit Nr. 1209, i mungojnë detajet që janë kërkuar në pikën 9 Detajet karakteristike arkitektonike të Përmbajtjes së projektit. Gjithashtu Projektit Nr. 1209 nuk ka prezentuar as rrethinat e ndërtesës që është kërkuar në pikën 10-Perspektiva e ndërtesës me rrethinë. Ju mungon kerkea nr. 11. Fotografi – perspektiva të enterierit të propozuar me detaje. Gjithashtu mungon edhe pika 12 e Përmbajtjes së Projektit; Paramasa dhe parallogaria për implementimin e punëve me specifikimin e materialeve dhe teknikën e punimeve.

Nëse shikohet tejet hollësisht OE 2607 nuk plotëson kërkesat teknike të përmbajtjes së projektit ide. OE 2607 nuk prezanton prerjet teknike por 3D. 3D nuk mund të zëvendësoj prerjet (planet vertikale) as në detyrë shkollore e lere më në konkurs publik.

Kostoja (Paramasa dhe parallogaria) nuk është lëndë e shqyrtimit të komisionit (jurisë) profesional.

- Përderisa në propozimin tonë 2607 prezentohen grafiksht detajet karakteristike të kërkuara nga AK (Shiko Detajet e paraqitura në pjesën grafike), Gjithashtu në pjesën grafike kemi paraqitur tetë (8) vizatime perspektivat e ndërtesës, posaçërisht raporti i ndërtesës me rrethinën. (Shiko Perspektivat, 1,2,3,4,5,6,7 dhe 8),

Po ashtu në propozimin tonë, pjesën tekstuale, pika e V. Punimet konservuese dhe adaptuese të ndërtesës, ne kemi pershkruar punimet e restaurimit, adaptimit, riorganizimit dhe rregullimin e hapësirave në Përdhësë dhe Kat, si dhe rregullimin e parterit.

Gjithashtu kemi paraqitur edhe paramasen me koston e përafërt të realizimit të punimeve

(Shiko pjesën tekstuale: Kostoja e Përafërt e realizimit të punimeve).

OE 2607 ofron hollësi teknike tipike nga katalogu i prodhuesve komercial (si: Knauf, Rigips et...). Këto hollësi nuk janë adoptuar objektit, për më tepër hollësia e mbështetjes së gips kartonit në pllakë betoni dhe jo në shtresën notuese (si Estrih).

Më e rëndësishmja OE 2607 nuk e përmbush kërkesën esenciale të AK të parashtruar në detyrën projektuese që objektit ti rikthehet dukja-pamja burimore (dhe jo ajo e tanishme).

Kjo nuk reflektohet me hapjet/dritaret e prezantuara në projekt ide të OE 2607

Numri 8 i faqeve të perspektivave nuk shton domosdoshmërisht pikë vlerësues.

Nën kriteri 3

Kriteri ekonomik (20), përfshinë:

Aspekti ekonomik i zgjidhjes së projektuar

Racionaliteti i zgjidhjes

Mirëmbajtja dhe shpenzimet e saj, bazuar në karakterin e objektit

Faktet:

- Projektit Nr. 1209 nuk e arsyeton ekonomikisht e as funksionalisht ndryshimin e vertikaleve të tualeteve duke shkaktuar kështu kosto shtese pa nevojë.

Shiko Vizatimin 04, Baza e katit

Nuk kam koment përpos, OE 2607 prap hyn në funksion të jurisë dhe bën vlerësime.

- Propozimi jone 2607 ruan në maksimum linjat e objektit duke minimizuar nderhyrjet në të dhe vertikale të tualeteve i vazhdon edhe në Kat –pa bërë modifikime tjera. Zgjidhja e ofruar e ndjek levizhmerinë natyrale dhe respekton detyrën projektuese duke ofruar zyrë të mëdha që ofrojnë komoditet në punë por duke nderhyrë sa më shumë kujdes në disa mure të holla. (shiko Baza e Përdhësës – Nderhyrja dhe Baza e Katit – Nderhyrja). Është menduar gjithashtu një pikë informimi si aneks i objektit që mund të shpërbejë edhe si pikë shitjeje të artizanateve me simbolike të qytetit të Prishtinës, gjë që do të ndihmonte në buxhetin për mirëmbajtjen e objektit në tërësi.

(shiko Situacioni i ngushte)

Nën kriteri 4

Kriteri i komunikacionit (10), përfshinë:

Lëvizjet pa pengesa e automjeteve

Parkimi

Garazhimi

Faktet:

- **Projektit Nr. 1209** ne paragrafin 5- PËRSHKRIMI I PROJEKT PROPOZIMIT, në piken 1.2

PARTERI DHE QASJA NE NEDERTESE parasheh 11 parkingjet ne bërthame të dy ndërtesave historike pa bërë analizë se si do ndikojë parkingu në lokacion dhe në hapësirën e gjëlberuar publike si dhe nuk e përfillë largimin e parkingjeve që është kërkesë edhe e detyrës projektuese;

Projektit Nr. 1209 zhvendos stacionin e autobusit nga ndërtesa e ish Kadastit përballë Shkollës së Parë shqipe-më afër rrethit ekzistues me cka e degradon objektin fqinj- Shkollën e Parë shqipe dhe ngarkon edhe më shume komunikacionin ne tërësi duke shkaktuar kaos ne rrethin ekzistues.

(shiko; Baza e Perdheses);

- Projekti jonë 2607 për shkak të lirimimit të hapësirës publike dhe qasjes më të mirë nga të gjitha anët në zonën e trajtuar propozon që parkingu të largohet sipas kërkesës dhe të vendoset në oborr të Kuvendit Komunal;

Stacioni i autobusit zhvendoset më në jug në këtë mënyrë duke e liruar qasjen në ndërtesë por edhe duke liruar rrethin dhe duke shkarkuar komunikacionin në përgjithësi.

(shiko; Situacioni i ngusht);

Parkingjet e punëtoreve janë paraparë jashtë pronës/zonës së përcaktuar me detyrë projektuese dhe atë në pronën e KK PR duke bërë shkelje të dyfishtë:

1. mos përmbushje të kërkesave esenciale nga detyra.
2. projektim të përmbajtjeve në pronë/zonë tjetër nga ajo e përcaktuar në detyrën projektuese.

Nen kriteri 5

Kriteri estetik dhe ekologjik / arkitektura e qëndrueshme (10),

përfshinë: Originaliteti i zgjidhjes

Inovacioni dhe vlera estetike

Zgjidhja konsekuente e tërësisë

Ruajtja dhe avansimi i hapësirës

Ruajtja e gjelbrimit ekzistues

Eficienca energjetike.

SHKELJA 3: Neni 80

Përbërja dhe Vendimet e Jurisë

Ndonese nuk jemi te informuar, por gjithsesi ligjit te prokurimit por edhe normave te trashëgimise kulturore, kuptojme qe te pakten njeri nga anetaret e jurisë duhet të jet ekspert në lemin e konservimit të ndërtesave të trashëgimisë kulturore.

Gjithashtu, nese i referohemi pikës 2 të ketij neni e që thotë **“Juria do të vendosë mbi konkursin vetëm në bazë të kriterëve të përshkruara në njoftimin për konkursin e projektimit”**, dhe e krahasojmë me vlerësimin që e ka bërë kjo juri, shohim qartë që Juria nuk ka vepruar kështu. Përkundrazi, kjo juri ka poentuar me pikët maksimale Koncept Projektin 1209, i cili qartazi nuk ka respektuar vet kërkesat e AK-së, pra Detyrën Projektuese.

AL-03

Pa koment.

OE prapë vlerëson dhe atë edhe jurinë dhe OE konkurrent.

SHKELJA 4

Gjatë analizes dhe krahasimit te koncept projekteve, shume lehte mund te verehet qe koncept projekti 1209 eshte vleresuar pa asnje te merite me piket maksimale perkunder faktit qe ky koncept projekt shkele ne menyre drastike te pakten 4 Pika kryesore te detyres projektuese, te cilat I kemi renditur me poshte.

Detyra projektuese për konservimni dhe adaptimin e ndërtesës së ish-kadastrit, Prishtinë

5. Detyra projektuese

5.1 Kërkesat specifike të dizajnit

5.2 Detyrat kryesore

Përmbajtja e projektit

Shkelja 5

Rregullat dhe Udhezuesi operativ per prokurimin publik.

Pika 41. Ekzamini, Vleresimi dhe krahasimi i tendereve

41.3 Tenderet duhet te plotesojne substancialisht kushtet obligative teknike te specifikuara. Pra edhe ne kete udhezim theksohet qe aplikuesit duhet t'i plotesojne kushtet obligative teknike.

Nuk e dijmë se si keni mund ta vlerësoni një koncept projekt i cili nuk ka plotësuar kërkesat e juaja!

AL-05

Pa koment.

Nga tre OE dy operatoret kanë përmbushur kërkesat bazike për vlerësim.

Edhe një herë nuk vlerëson OE po AK(përmes) jurisë.

Përndryshe nëse shikohet tejte hollësisht OE 2607 nuk plotëson kërkesat teknike të përmbajtjes së projektit ide. OE 2607 nuk prezanton prerjet teknike por 3D. 3D nuk mund të zëvendësoj prerjet (planet vertikale) as në detyrë shkollore e lere më në konkurs publik.

Andaj duke u bazuar në të gjitha provat dhe argumentet e prezantuara si dhe nenin 80.4 te Ligjit për Prokurimin Publik, i cili nen përcakton "Asnjë person jashtë jurisë nuk mund të ndikojë ose të tentojë të ndikojë në vendimet e jurisë ose në opinionin e cilitdo nga anëtarët e jurisë, Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitivin e cekur më lartë.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimiit te ketij vendimi.